

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7855  
E mërkurë, 7 gusht 2024  
Çmimi 0.50

Në Deçan zbulohet  
shtatorja e heroinës së  
kombit Fetnete Ramosaj

FACE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## LULZIM PEÇI: KOSOVA PO SHKON DREJT NJË PËRPLASJEJE TË MADHE ME NDËRKOMBËTARËT

FACE 3



Ish-diplomati i Kosovës, Lulzim Peçi, aktualisht drejtor i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), ka thanë për "Radio Evropa e Lirë" se veprimet e fundit të autoriteteve të Kosovës në veri të

vendit janë duke e thëlluar çarjen në mes të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, sepse ajo ka para vetes një partner "i cili është i paparashikueshëm". "Kosova është duke shkuar në drejtim të një përplasjeje të

madhe me bashkësinë ndërkombëtare, mirëpo Kosova nuk ka kapacitet ta dëmtojë bashkësinë ndërkombëtare. Mund ta dëmtojë vetëm vetveten", ka deklaruar Lulzim Peçi

**PRESIDENCA:  
MËNYRA SI INCIDENTI  
U TRAJTUA NË  
KONFERENCËN  
KURTI - MICKOSKI  
ËSHTË PËR KEQARDHJE** F.4



**HARRISI ZGJEDH GUVERNATORIN  
E MINESOTËS KANDIDAT  
PËR ZËVENDËSPRESIDENT** F.2



### AKTUALE



**SHBA-ja, BE-ja DHE GJERMANIA  
SHPREHIN ZHËNJIM ME  
VENDIMIN E KOSOVËS PËR  
MBYLLJE TË DEGËVE TË  
POSTËS SË SERBISË NË VERI** F.7

**PARAQITET PROPOZIMI FITUES  
PËR ZHVILLIMIN E MASTERPLANIT  
TË KOMPLEKSIT MEMORIAL  
"ADEM JASHARI" NË PREKAZ** F.5



**SVEÇLA MBRON AKSIONIN PËR  
MBYLLJEN E DEGËVE TË POSTËS  
SË SERBISË** F.8

**KOMUNA E RAHOVECIT MBAN  
DËGJIMIN BUXHETOR ME  
PËRFAQËSUESIT E OJQ-VE,  
BIZNESEVE, FERMERËVE  
DHE TË RINISË** F.8

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Harrisi zgjedh guvernatorin e Minesotës kandidat për zëvendëspresident

WASHINGTON, 6 GUSHT - Kandidatja demokrate për presidente, Kamala Harris, zgjodhi të martën guvernatorin e Minesotës, Tim Walz, si kandidat për zëvendëspresident nga pjesa qendrore e Amerikës, në një përpjekje të dukshme për ta zgjeruar bazën e votuesve duke tërhequr votuesit ruralë, të bardhë, njoftojnë mediet amerikane duke iu referuar burimeve me dijeni për këtë çështje.

60-vjeçari Walz, një veteran i Gardës Kombëtare të Ushtrisë Amerikane dhe ish-mësues, u bë anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve në vitin 2006, duke fituar në një distrikt me prirje republikane dhe shërbeu për 12 vjet përpara se të zgjidhej guvernator i Minesotës në vitin 2018.

Si guvernator, Walz ka ndjekur një agjendë progresive që, mes të tjerave, përfshin masa për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike, uljen e taksave për

klasën e mesme dhe zgjerimin e lejes së paguar për punonjësit e Minesotës. Ai ka mbrojtur prej kohësh të drejtat riprodhuese të grave, gjithashtu ka shfaqur prirje konservatore, duke mbrojtur interesat e fermerëve dhe të drejtën për armëmbajtje. Ishte vendimi i parë madhor i Harrisit si kandidate presidenciale e Partisë Demokratike dhe një hap tjetër në fushatën e saj për ta fituar Shtëpinë e Bardhë në nëntor.

Njoftimi erdhi një ditë pasi Harris siguroi zyrtarisht emërimin kandidat e partisë së saj për presidente, pas një raundi pesëditor votimi në internet nga delegatët e Kuvendit Kombëtar Demokratik që përfundoi të hënën në mbrëmje.

Në një deklaratë pak para mesnatës, Komiteti Kombëtar Demokrat tha se 99 % e delegatëve kishin votuar në favor të Harrisit. Votimi do të certifikohet zyrtarisht në



Kuvendin e partisë në Çikago.

Harris, gruaja e parë dhe politikania e parë me prejardhje afrikano-amerikane dhe indiane që shërben si zëvendëspresidente, bëhet kështu gruaja e parë jo e bardhë si kandidate zyrtare e njërës prej partive kryesore.



Lista e kandidatëve për nënpresident ishte ngushtuar në mes të guvernatorit të Pensilvanisë, Josh Shapiro dhe guvernatorit të Minesotës, Tim Walz, i thanë agjencisë "Reuters" disa burime të hënën. Walz, 60 vjeç, shërben si guvernator në një shtet që voton

vazhdimisht për demokratët, por ka treguar se është i pëlqyer mes votuesve të bardhë, ruralë, të cilët vitet e fundit kanë votuar gjerësisht për zotin Trump.

Amerikanët zakonisht përqendrohen te kandidati për president kur zgjedhin se për kë të votojnë, por kandidatët për nënpresident mund të ndihmojnë ose dëmtojnë kandidatët e tyre bazuar në prejardhjen, popullaritetin në shtetin e tyre dhe aftësinë për të ndikuar në zona të rëndësishme elektorale ose tek votuesit e pavarur.

Senatori JD Vance, kandidati për nënpresident i përzgjedhur nga ish-presidenti Donald Trump nga shteti i Ohajos, ka shkatkuar reagime me komentet e tij për gratë që nuk kanë fëmijë, mes shqetësimeve se ato do të ndikojnë te vota e grave. Në tubime fushate këtë javë, ai pritet ta kritikojë Harrisin lidhur me ekonominë dhe imigracionin.

## Gjykatësi amerikan thotë se Google ka krijuar monopol të paligjshëm

WASHINGTON, 6 GUSHT - Një gjykatës amerikan vendosi se kompania Google ka shkelur ligjin, pasi ka shpenzuar miliarda dollarë për të krijuar një monopol të paligjshëm dhe është bërë motori kryesor i kërkimeve në botë. Kjo është fitorja e parë e madhe e autoriteteve federale kundër dominimit të tregut nga kompanitë e mëdha të teknologjisë.

Vendimi i hap rrugën mbajtjes së gjykimit të dytë për të përcaktuar për mënyrat se si mund të përmirësohet kjo çështje, përfshirë ndarjen e Alphabet nga Google, që do ta ndryshonte peizazhin në botën e reklamimit online, që Google e ka dominuar për vite të tëra.

Vendimi i gjykatësit, Amit Mehta, po ashtu i jep dritën e gjelbër zbatimit më të fuqishëm të ligjit nga ShBA-ja kundër kompanive të mëdha të teknologjisë.



"Gjykata ka ardhur në këtë përfundim: Google është monopolist, ka vepruar si një për ta mbajtur monopolin", tha Mehta në vendim.

Në vendimin e gjykatësit të qarkut në Uashington u tha se Google kontrollon rreth 90 për qind të tregut të kërkimeve online dhe 95 për qind të

kërkimeve që bëhen përmes telefonave të mençur.

Faza e "zgjidhjes" mund të jetë e gjatë, pasi ka mundësi që të dërgohen apele në Gjykatën e Apelit në qarkun e Kolombias, por edhe në Gjykatën Supreme. Ky proces ligjor mund ta zgjasë gjithë vitin e ardhshëm, madje edhe në vitin 2026.

Aksionet në Alphabet ranë për 4.5 për qind të hënën, pas rënies së aksioneve të shumë kompanive të teknologjisë. Reklamimi i kompanisë Google në Alphabet përbënte 77 për qind të shitjeve të përgjithshme në vitin 2023.

Alphabet tha se planifikon ta apelojë vendimin e gjykatësit Mehta. "Ky vendim thotë se Google ofron motorin më të mirë të kërkimeve, por thotë se ne nuk duhet të lejojmë që një gjë e tillë të jetë e qasshme kaq lehtësisht", u tha në deklaratën e kompanisë Google.

Prokurori i Përgjithshëm i ShBA-së, Merrick Garland, e quajti vendimin "fitore historike për popullin amerikan" dhe shtoi se "asnjë kompani, pavarësisht sa e madhe dhe sa ndikim ka, nuk është mbi ligjin".

Mehta tha se Google kishte paguar 26.3 miliardë dollarë vetëm më 2021 për t'u siguruar që motori i kërkimeve të

kompanisë të ishte kryesori për telefonat e mençur dhe për ta mbajtur dominimin në treg.

Në katër vitet e fundit rregullatorët federalë kanë paditur, po ashtu, platformat Meta, Amazon.com dhe Apple duke pretenduar se kompanitë në mënyrë të paligjshme kanë krijuar monopol. Të gjitha këto raste kishin nisur në kohën kur president ishte republikani Donald Trump.

Rasti ndaj Google-s u ngrit më 2020 dhe ishte hera e parë që qeveria amerikane akuzonte një korporatë të madhe për monopol të paligjshëm.

Më 2004 Microsoft kishte arritur një marrëveshje me Departamentin Amerikan të Drejtësisë lidhur me akuzën se kompania i detyronte përdoruesit e Windows-it që të përdornin Internet Explorer si makinë kërkuese në kompjuterët e tyre.

## Greqia shpëton 75 emigrantë

Athinë, 6 gusht - Rojet bregdetare greke thanë se kanë shpëtuar 75 emigrantë në një prej zonave në Detin Mesme ku vitin e kaluar u fundos një anije që po bartte qindra emigrantë.

Sipas rojeve bregdetare, emigrantët e shpëtuar po udhëtonin me një varkë afër qytetit Pulos dhe do të dërgohen në portin e Kalamatës, thanë

Rojet më 6 gusht.

Autoritetet greke nuk treguan për kombësinë e emigrantëve të shpëtuar.

Në qershor të vitit 2023 një varkë e stërmbushur me emigrantë, që besohet se ishte nisur nga Libia me më shumë se 750 njerëz në bord, u fundos në jugperëndim të Pilos.

Autoritetet thanë se 104 prej tyre u

shpëtuan, ndërkaq 600 të tjerë konsiderohen se janë zhdukur.

Dhjetëra të mbijetuar ngritën padi ndaj rojeve bregdetare greke, duke pretenduar se ata reagues pas disa orësh, pavarësisht prej paralajmërimeve që ua kishte dërguar agjencia kufitare e Bashkimit Evropian, Frontex dhe organizata joqeveritare Alarm Phone.



# Lulzim Peci: Kosova po shkon drejt një përplasjeje të madhe me ndërkombëtarët

Ish-diplomati i Kosovës, Lulzim Peci, aktualisht drejtor i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), ka thanë për "Radio Evropa e Lirë" se veprimet e fundit të autoriteteve të Kosovës në veri të vendit janë duke e thelluar çarjen në mes të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, sepse ajo ka para vetes një partner "i cili është i paparashikueshëm". "Kosova është duke shkuar në drejtim të një përplasjeje të madhe me bashkësinë ndërkombëtare, mirëpo Kosova nuk ka kapacitet ta dëmtojë bashkësinë ndërkombëtare. Mund ta dëmtojë vetëm vetveten", ka deklaruar Lulzim Peci



**PRISHINË, 6 GUSHT** - Ish-diplomati i Kosovës, Lulzim Peci, aktualisht drejtor i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), ka thanë për "Radio Evropa e Lirë" se veprimet e fundit të autoriteteve të Kosovës në veri të vendit janë duke e thelluar çarjen në mes të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, sepse ajo ka para vetes një partner "i cili është i paparashikueshëm". ShBA-ja dhe BE-ja e cilësuan mbylljen e Postës së Serbisë në veri, më 5 gusht, si "veprim të njëanshëm dhe të pakoordinuar". Ky veprim i autoriteteve të Kosovës pasoi me qëndrimin e QUINT-it dhe NATO-s që thanë se nuk e mbështesin hapjen e urës së Ibrit në Mitrovicë në këtë kohë, pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i informoi për planin e hapjes së urës.

*Z. Peci, bashkësia ndërkombëtare edhe një herë reagoi kundër, siç tha, veprimet e pakoordinuara dhe të njëanshme të autoriteteve të Kosovës kur është fjala për verium e vendit. E fundit është mbyllja e zyrave të Postës së Serbisë. Si i shihni ju këto reagime?*

**Lulzim Peci:** Unë mendoj se këto reagime janë rrjedhojë e politikës së bashkësisë ndërkombëtare rreth veriut të Kosovës, aty ku KFOR-i e ka përgjegjësinë më të lartë për sigurinë në këtë pjesë të vendit. Edhe për këtë arsye ata nuk dëshirojnë të jenë të tejkaluar për veprimet të cilat merren nga Policia e Kosovës në veri të vendit, duke e pasur parasysh edhe përgjegjësinë e tyre që e kanë.

Mendimi im është që ata nuk dëshirojnë të kurthohen në ndonjë tension ndërkombëtar apo diçka të ngjashme pa qenë paraprakisht të njoftuar. Kjo sepse, nëse situata eskalon, atëherë është KFOR-i ai që duhet të ndërhyjë. Mendoj që ajo që bëjë jo ndoshta me veprimin, me mbylljen e zyrave të postës serbe në veri, sa ka të bëjë me qasjen e Qeverisë së Kosovës.

*A po thellohet çarja në mes të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, meqenëse nuk është hera e parë që ndërkombëtarët po reagojnë në mënyrë të tillë? Para disa ditësh kishim edhe reagimin lidhur me hapjen e urës. Ka pasur reagime të fuqishme lidhur edhe me ndalimin e dinarit, mbylljen e institucioneve të ndryshme të Serbisë në Kosovë.*

**Lulzim Peci:** Po, çarja është duke u thelluar, sepse partneriteti nuk mund të ndërtohet nëse nuk konsultohen palët, të cilat kanë përgjegjësi të sigurisë në veri të vendit. Edhe çarja mendoj që tashmë është thelluar shumë, sepse bashkësia ndërkombëtare ka përpara një partner të vetin. Si e shikon ajo në këtë mënyrë një partner, i cili nuk është i paparashikueshëm dhe i cili ndërmer veprime pa konsultime paraprake në këtë pjesë të vendit, duke i pasur parasysh përgjegjësitë në fushën e sigurisë. Pra, ta kemi parasysh se për çka jemi duke folur. Nuk jemi duke folur vetëm për zbatim të ligjit, po jemi duke folur edhe për implikimet e sigurisë në

atë pjesë të vendit.

*Megjithatë, autoritetet e Kosovës i arsyetojnë këto veprime të tyre në këto institucione, të cilat janë mbyllur, duke thënë se kanë punuar ilegalisht në Kosovë dhe thirren në ligjshmëri.*

**Lulzim Peci:** Po, krejt në rregull, po e kemi ligjshmërinë dhe i kemi palët, të cilat kanë mandat të sigurisë në pjesën veriore të vendit. Edhe kur vjen puna te zbatimi i ligjit, krejt në rregull, nuk ka dyshim për atë, mirëpo kjo duhet të bëhet në konsultim dhe në koordinim me ata të cilët kanë përgjegjësi të sigurisë në atë pjesë të vendit. Mos të harrojmë se Kosova nuk e ka sovranitetin e plotë dhe derisa KFOR-i e ka këtë mandat të cilin e ka sot, dihet se si janë gjërat. Dhe këtu qëndron problemi. Nuk qëndron problemi te zbatimi i ligjit. Problemi qëndron në atë se a jemi partnerë të besueshëm apo jo?

*Nga ana tjetër, edhe pse Bashkimi Evropian i ka vënë sanksione*

*Kosovës, ShBA-ja, pos me deklarata, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim sanksionues. A mund të pritët diçka që mund të vendosë ShBA-ja në këtë drejtim?*

**Lulzim Peci:** Sanksionimin më të madh që na e ka bërë ShBA-ja, është që Kosovës ia ka tërhequr përkrahjen që e ka pasur përpara. Sanksion më të madh nuk ka.

*Si mendoni, cilën përkrahje?*

**Lulzim Peci:** Kosova më nuk e ka përkrahje në fushën ndërkombëtare, të cilën e ka pasur përpara prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kosova i është lënë vetvetes dhe ajo tani është vetëm duke u trajtuar në domenin e menaxhimit të konfliktit. Asgjë më shumë.

*Nga është duke shkuar Kosova?*

**Lulzim Peci:** Kosova është duke shkuar në drejtim të një përplasjeje të madhe me bashkësinë ndërkombëtare, mirëpo Kosova nuk ka kapacitet ta dëmtojë bashkësinë ndërkombëtare. Mund ta dëmtojë vetëm vetveten.



## Në Deçan zbulohet shtatorja e heroinës së kombit Fetnetë Ramosaj

**DEÇAN, 6 GUSHT** - Në komunën e Deçanit është zbuluar shtatorja e heroinës së kombit Fetnetë Ramosaj. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, deputetë dhe

përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se bashkëluftëtarja Fetnetë Ramosaj përmes veprave siguroi që koha mos ta ndalë kujtesën për luftën tonë të lavdishme. "Ajo bëri luftë të

dyfishtë, në front dhe si kroniste, duke dëshmuar të vërtetën e luftës së UÇK-së, dhe duke e përjetësuar luftën çlirimtare dhe mbajtjen gjallë idealin e lirisë ndër breza. Përjetë falënderues dhe mirënjohës ndaj heroinës Fetnetë Ramosaj!", ka thënë Haradinaj.



## Presidenca: Mënyra si incidenti u trajtua në konferencën Kurti - Mickoski është për keqardhje

Presidenca e Kosovës tha se është “për keqardhje” mënyra se si u trajtua incidenti i 1 gushtit gjatë konferencës për medie më 5 gusht të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe homologut të tij maqedonas, Hristijan Mickoski, në Shkup. Gjatë konferencës, Hristijan Mickoski tha se i vjen keq për incidentin në Aeroportin e Shkupit, ku u përfshi presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Ndërkaq homologu i tij, Albin Kurti, tha se një raport zyrtar do ta zbardhë të gjithë ngjarjen

**EPOKA ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 6 GUSHT** - Presidenca e Kosovës ka reaguar sërish në lidhje me incidentin që i ndodhi ditë më parë në Aeroportin e Shkupit presidentes Vjosa Osmani. Në reagimin për medie, thuhet se presidentja e Republikës së Kosovës asnjëherë nuk ka kërkuar tejkallim apo shkelje të procedurave, por respektim të rregullave ndërkombëtare, siç bëhet në të gjithë botën. “Lista e shteteve të cilat i ka vizituar presidentja Osmani gjatë mandatit të saj si presidente përfshin ShBA-në, Shqipërinë, Turqinë, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Italinë, Austrinë, Belgjikën, Bullgarinë, Çekinë, Finlandën, Kanadanë, Kosta-Rikën, Kroacinë, Danimarkën, El Salvadorin, Estoninë, Francën, Greqinë, Islandën, Japoninë, Lituaninë, Luksemburgun, Maltën,

Moldavinë, Malin e Zi, Panamanë, Portugalinë, Katarin, Singaporin, Slloveninë, Spanjën, Zvicrën, Tajlandën, Tunizinë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Vatikanin etj. Të gjitha këto shtete, shumicën prej të cilave i ka vizituar disa herë gjatë mandatit, pa përjashtim, i kanë respektuar plotësisht rregullat ndërkombëtare sa i përket trajtimit të kreut të shtetit, rrjedhimisht edhe të vet shtetit. Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidentja e vendit përfaqëson shtetin brenda dhe jashtë. Pavarësisht prej rregullave jashtëzakonisht strikte të sigurisë në aeroportet e shumicës së shteteve të lartpërmendura, ata e pranojnë presidentin e një shteti si përfaqësuesin më të lartë të shtetit dhe kurrë nuk kërkojnë skanimin as të çantës personale e lëre më të telefonit, aq më pak të kërkohet ‘full body scan’, sepse kjo, mes të tjerash, do të nënkuptonte se janë duke e

trajtuar shefin e shtetit - rrjedhimisht shtetin - si rrezik potencial për terrorizëm”, thuhet në reagimin e Presidencës, për të vazhduar tutje: “Në çdo vend ku udhëtojmë nuk është presidentja që e kërkon një trajtim të tillë. Ky trajtim ofrohet automatikisht nga shtetet pritëse bazuar në njoftimin që bëhet nga ambasadat tona për udhëtimin e presidentes dhe bazuar në të drejtën ndërkombëtare zakonore (e detyrueshme për të gjitha shtetet). Siç shihet nga lista e lartpërmendur, kjo është respektuar në tërësi edhe nga shtete që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Se kjo procedurë respektohet çdoherë e çdokund, presidentja Osmani e ka konfirmuar edhe me homologë të saj me të cilët ka biseduar këto ditë”, thuhet në reagim. Më tej theksohet se presidentja e Republikës së Kosovës kërkon respekt për shtetin që përfaqëson, pra Republikën e

Kosovës, dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë me ngulm në përputhje me rregullat e parimet ndërkombëtare që rregullojnë raportet ndërmjet shteteve. “Raportet për incidentin e paprecedentë në Aeroportin e Shkupit të përgatitura nga Presidenca dhe Policia e Kosovës janë tashmë të finalizuara dhe të qasshme, dhe kanë qenë tash e sa ditë. Nga këto raporte kuptohet qartë se nuk ka kërkesë për devijim ose anashkallim të rregullave por, përkundrazi, respektim dhe aplikim të konventave dhe të së drejtës ndërkombëtare zakonore e, mbi të gjitha, respekt për Republikën e Kosovës. Mënyra se si u trajtua incidenti ndaj Republikës së Kosovës në Shkup gjatë konferencës së djeshme për medie është për keqardhje, sepse i ka kontribuar edhe më shumë propagandës kundër Republikës së Kosovës. Ajo që ka ndodhur në Aeroportin e Shkupit ka qenë shkelje e qartë e rregullave ndërkombëtare të njohura dhe aplikuar botërisht, prandaj Presidenca pret të njoftohet për masat e ndërmarra lidhur me këto shkelje, ashtu siç është potencuar edhe në notën e protestës të drejtuar nga Republika e Kosovës”, vazhdon reagimi.

Presidenca ka shprehur keqardhje për mënyrën se si incidenti u trajtua në konferencën Kurti - Mickoski në Shkup. “Përderisa e vlerësojmë shprehjen e keqardhjes nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, për fat të keq, deri tani në asnjë moment institucionet e Maqedonisë së Veriut nuk i kanë trajtuar çështjet e ngritura në notën e protestës që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës ndërkombëtare zakonore në raport me Republikën e Kosovës por, përkundrazi, hapur e pa asnjë hezitim e kanë pranuar një shkelje të tillë. Për këtë as nuk duhen raporte e hetime shtesë për ndonjë gjendje faktike, sepse ato janë komplet jorelevante para pranimit publik të institucioneve të Maqedonisë së Veriut, se një rregull i tillë është imponuar qëllimshëm, pavarësisht prej kërkesave të qarta të së drejtës ndërkombëtare”, thuhet në reagimin e Presidencës. Më tutje thuhet se Presidenca e Republikës e ka trajtuar këtë incident vetëm në mënyrë ndërinstucionale e pa e bërë publike, me qëllim të ruajtjes së raporteve ndërmjet dy shteteve, deri në momentin kur një propagandë e përmasave të papara ka filluar kundër

# Paraqitet propozimi fitues për zhvillimin e masterplanit të Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 GUSHT - Në kryeqytetin e Kosovës është paraqitur propozimi fitues për zhvillimin e masterplanit të Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Me këtë rast, i ftuar si folës kryesor ishte kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti cilësoi se Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz është vendi më i rëndësishëm i kujtesës kombëtare, e konceptuar si Oda e Kombit, ku ne rikthehemi që ta kujtojmë çmimin dhe rrënjët e lirisë të cilën e gëzojmë sot. “Jemi shumë të lumtur që ky masterplan do të hartohet nga një ekip ekspertësh ndërkombëtarë me përvojë shumëdekadëshe. Me padurim pres të përcjell së bashku me të gjithë ju, prezantimin e propozimit fitues, me bindjen që ky propozim do të ofrojë një interpretim dinjitoz e gjithëpërfshirës, për rrëfimin e historisë së familjes Jashari”, tha ai para se të shtonte se rrëfimi i cili do t'i tejkalojë barrierat kohore të brezit tonë dhe ato hapësinore të vendit tonë, dhe kujtimin për veprën heroike të familjes Jashari, do ta shndërrojë në përjetësi botërisht.

Sipas këtij propozimi, Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, i shtrirë në një hapësirë prej 450 hektarësh, do ta marrë pamjen dhe trajtën e një peizazhi historik kompleks, në të cilin vizitat do të jenë udhëtime në tërë historinë e Jasharëve të Prekazit: nga

gjenealogjia të strukturat e familjeve; nga tradita e rezistencës të kultura e patriotizmit; nga stërviçet ushtarake në Shqipëri dhe rrethimi i parë i familjes së Shaban Jasharit më 1991 të themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; nga aksionet e para të armatosura të organizimit e grupeve të armatosura; nga betejet e para të UÇK-së në Klysyre dhe të Gjashtë Lisat deri të rrethimi i dytë i 22 janarit 1998; dhe veçanërisht nga rrethimi i tretë dhe qëndresa e 5, 6 dhe 7 marsit 1998 që shënoi Epopenë e UÇK-së të trashëgimia e gjithë çfarë përfaqëson Adem Jashari, familja Jashari dhe historia e tyre deri sot për çlirim dhe shtetndërtim të vendit tonë nga populli ynë, përshkroi kryeministri. “Nuk do të kursejmë asgjë për të ndërtuar një kompleks memorial të rëndësishëm ndërkombëtarisht, i cili do të pasqyrojë dinjitetshëm dhe me një nivel të lartë artistik, qëndresën dhe luftën e popullit për liri dhe drejtësi, pavarësi dhe bashkim, ashtu siç e meriton figura e Adem Jasharit dhe e familjes Jashari”, tha në fund të fjalës së tij kryeministri.

Në këtë ngjarje të pranishëm ishin edhe pjesëtarë të familjes Jashari, baca Rifat e Bekim Jashari, krahas anëtarëve të shumtë të kabinetit, kryetarit të komunës Skenderajt, deputetëve të Kuvendit, përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës, anëtarëve të Komitetit ndërministror dhe të Komisionit të Ekspertëve të Kompleksit Memorial “Adem



Jashari”. Në emër të familjes Jashari, Bekim Jashari tha se hartimi i projektit të Kompleksit Memorial “Adem Jashari” është një hap i shumëpritur për ta parandaluar dëmtimin edhe më të madh të kullave që dikur ishin të babës Shaban, por sot janë të gjithë shqiptarëve. Ai tha se ndërtimi i Kompleksit Memorial “Adem Jashari” është obligim ndaj mijëra vizitorëve nga trojet shqiptare që e vizitojnë Prekazin dhe kthehen të mbushur me krenari, por nuk e fshehin as dëshirën e madhe që të shohin një kompleks të konservuar, një muze funksional dhe modern dhe me hapësira më të mëdha për të kaluar kohë me familjet e tyre. Bekim Jashari shtoi se me

këtë kompleks le t'i tregojmë botës për historinë tonë të lavdishme, t'i dëshmojmë për luftën e drejtë dhe jetën e re që kemi ndërtuar si një shoqëri demokratike, shembull për shtetet dhe shoqëritë në rajon. Konsorciumi fitues përbëhet nga ndërmarrjet ndërkombëtare Gerber Architektent Internacional nga Gjermania, Donald Insall Associates nga Mbretëria e Bashkuar dhe Barker Langham nga Mbretëria e Bashkuar, të cilat kanë një përvojë të gjatë në zhvillimin e projekteve anembanë botës: në fushën e projektimit të arkitekturës dhe inxhinierisë, të konservimit, planifikimit hapësinor, kurimit e muzealizimit, ndër të tjera.

Kontrata e nënshkruar parasheh hartimin e projekteve e planeve ideore e zbatuese, gjithsej 21 produkte, ku përfshihen masterplani për tërë Kompleksin Memorial; Projektet e Konservimit dhe Interpretimit të Kullave të Rezistencës dhe monumenteve të tjera në kuadër të kompleksit; Programi kuratorial; Planet e hollësishme rregulluese; Projektet për Fabrikën e Municionit dhe Gardën Ceremoniale të Forcave të Sigurisë së Kosovës.

Puna për hartimin e këtyre planeve e projekteve është parashikuar të realizohet brenda 22 muajve. Paralelisht me hartim të planeve do të nisë edhe zbatim i projekteve të përfunduara.

Presidentes, me ç'rast Presidenca është detyruar t'i përgjigjet interesimit të shumtë të medieve. “Siç është thënë edhe në reagimet e mëparshme, presidentja Osmani përgjatë tërë karrierës së saj politike, në veçanti përgjatë mandatit të saj si presidente e vendit, ka kontribuar në zhvillimin dhe thellimin e raporteve pozitive me Maqedoninë e Veriut. Mirëpo ajo nuk mund ta pranojë, në asnjë mënyrë, baltosjen e Republikës së Kosovës. Kjo situatë është lehtë e tejkaloeshme nëse ekziston vullnet politik nga Shkupi zyrtar”, përfundon reagimi i Presidencës së Kosovës.

Presidenca e kishte cilësuar si “provokim të pastër dhe tendencë për të shkaktuar incident” ngjarjen që ndodhi në Aeroportin e Shkupit. Por, kryeministri Albin Kurti kur u pyet në Shkup nëse Kosova mban ende qëndrimin se kjo ngjarje ishte provokim, ai tha se

## Çfarë tha Presidenca për incidentin në aeroport?

Presidenca e Kosovës i ka akuzuar autoritetet e Maqedonisë së Veriut për shkelje të praktikave ndërkombëtare dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike, duke thënë se gjatë 1 gushtit presidentes Vjosa Osmani është tentuar t'i merret telefoni personal nga një pjesëtar i sigurimit të Aeroportit të Shkupit (TAV).

Incidenti ka ndodhur para udhëtimit të planifikuar të Osmanit drejt Sllovenisë, ndërsa Presidenca e Kosovës nuk ka bërë të ditur nëse qëllimi i udhëtimit të saj ka qenë zyrtar apo i natyrës private.

Presidenca e Kosovës ka thënë se përkundër se i janë bërë të ditura rregullat diplomatike,

sigurimi “ka tentuar fizikisht ta shtyjë presidenten, me ç'rast është detyruar të reagojë Policia e Kosovës për ta hapur rrugën”.

Ky institucion ka thënë se ndodhitë e 1 gushtit nuk mund të vlerësohen ndryshe, veçse “një provokim i pastër dhe tendencë për të shkaktuar incident”.

Presidenca e Kosovës tha më 2 gusht se në vend se të kërkojë falje, MPB-ja maqedonase “ka arsyetuar në tërësi kërkesën e sigurimit të aeroportit për ta marrë dhe për ta vendosur në skaner telefonin personal të presidentes së Kosovës, i cili përdoret nga kreu i shtetit edhe për komunikime zyrtare për çështje të sigurisë nacionale”.

nuk e di që institucionet kanë pasur një qëndrim të tillë dhe këtë mund ta ketë thënë ndonjë “qytetar”, por jo edhe institucionet e Kosovës, duke theksuar se Ministria e Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës përmes njoftimeve ka shprehur qëndrimin e qeverisë. Ai tha se

për këtë rast “do të ketë një raport zyrtar që do ta zbardhë këtë çështje në tërësi, edhe që të kuptojmë se çfarë saktësisht ka ndodhur, por edhe që të mos na përsëriten më kurrë situata të tilla”.

Autoritetet maqedonase kanë thënë se kushdo që ka bërë

shkelje në rastin e incidentit në Shkup do të përballet me përgjegjësi penale.

Incidenti ku u përfshi Osmani ka shkaktuar reagime të shumta të përfaqësuesve të opozitës dhe të partive shqiptare që janë në koalicionin qeverisës në Maqedoninë e Veriut, të cilat e

kanë fajësuar njëra-tjetrën. Pavarësisht prej kësaj ngjarjeje, Kurti dhe Mickoski thanë se raportet mes shteteve janë të mira. Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë raporte diplomatike dhe deri më tani nuk kanë pasur incident të kësaj natyre.

# Mehmet Loci duhet të shkojë te Blerim Isufaj e jo te Ermal Panduri



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Jo i ndëshkuar, por krim i afirmuar: TV Dukagjini muajin gusht ua ka kushtuar rrëfimeve të ish-të burgosurve politikë në emisionin "Debat Plus" e që po udhëhiqet, e them shkëlqyeshëm nga Ermal Panduri. Në këto rrëfime, të gjitha të vërteta, të dhimbshme dhe të trishta, ish-të burgosurit politikë shqiptarë përfaqësojnë me mijëra e mijëra të tjerë që kanë kaluar të njëjtën Rrugë të Golgotës por se nuk kanë mundësi t'i bëjnë publike përjetimet e tmerrshme falë, në radhë të parë, terrorin që ndaj tyre e kanë ushtruar pjesëtarët e UDB-së jugosllave dhe serbe, bastardë që kanë lindur si shqiptarë e që kanë qenë më të këqij se udbashi më i keq serb. Për dhunë të shfrenuar kanë qenë të njohur "shqiptarët" udbash nga Lugina e Preshevës përkatësisht nga Medvegja. Sikur edhe disa gjakovarë, pejanë, mitrovicali dhe drenicakë. Edhe më parë kishte informata të fragmentarizuara për këtë

dhunë duke përmendur emra të përveçëm të udbashëve bastardë shqiptarë nga Nait Hasani dhe Gani Koci dhe, çuditërisht, në vend se të merreshin masa ndaj tyre, me të gjitha mjetet bëheshin përpjekje që deklaratat e Naitit dhe Ganiut të marginalizohen duke ua ngushtuar hapësirën të tjerëve. Kategoria që më së keqi është trajtuar në Kosovë pas përfundimit të luftës janë të burgosurit politikë. Shteti ka menduar se me një kompensim, më shumë ofendues se ndihmues, do t'i shlyejë borxhet ndaj kësaj kategorie jashtëzakonisht sakrifikuere. Dhe, këtu e ka mbyllur tregimin pa e bërë as përpjekjen më të vogël të sigurojë drejtësi për vuajtjet e tyre. Të sigurojë kushte për rehabilitim shëndetësor shkaku se shumica ishin me shëndet të rrënuar. Të sigurojë kushte për shkollim dhe aftësim profesional shkaku se për shkak të dënimeve të gjata nuk kishin mundësi të shkollohen. Të sigurojë kushte për punësim duke krijuar raste sociale. Për ilustrim, një hetues i UDB-së, një prokuror apo gjykatës, që kanë punuar pa asnjë pengesë nën pushtetin e UNMIK-ut dhe institucioneve të Kosovës (pavarësisht partive politike) kanë përfituar më shumë se 100 të burgosur politikë që janë kompensuar. Mos të flasim për fëmijët e tyre që janë shndërruar në milionerë në

saje të aktiviteteve kriminale antikombëtare të prindërve të tyre udbash ose që kanë qenë të lidhur me kërthizë me Jugosllavinë dhe Serbinë, kundër shqiptarëve. Edhe sot fëmijët e tyre janë pronarë të mediave, pronarë të mëdhenj të tokave, ndërtesues të pallateve, thithës miliona fondesh të ndërkombëtarëve dhe vendore, në diplomaci, borde, këshilltarë politikë, udhëheqës të ndërmarrjeve përfituese, në Universitet, në QKUK dhe thuaja në të gjitha vendet ku ka shumë para dhe ndikim. Ku janë të burgosurit politikë dhe fëmijët e tyre?! Në vartësi materiale nga të parët dhe në përndjekje nga ta. Në prapaskenë punuan për themelimin e Gjykatës Speciale duke bashkëpunuar me Serbinë dhe ndërkombëtarët për ndërtimin e trillimit për Shtëpinë e Verdhë dhe trafikim me organe. Dërguan dosje partiake dhe personale në Gjykatë të Hagës. Sigurojnë dëshmitarë të mbrojtur sikur që edhe vet janë dëshmitarë. Të rrejshëm duke e sulmuar UÇK-në dhe udhëheqësit e tyre, deri sa i dërguan në Hagë. Të pafytyrë dhe të poshtër. Qenie me anatomi njerëzore por pa asnjë përmbajtje njerëzore! Reagimet pas këtyre rrëfimeve: Kanë dhe kishin përkrashje nga kontribuuesit për lirinë e Kosovës dhe çështjen kombëtare. Institucionet përkatëse, KM, Presidentja,

Kryefolësi i Kuvendit nuk reagon fare. As ajo që deklarohet si Ministre e Drejtësisë, ndonëse nuk ka lënë pa e komentuar çdo dhunë (edhe në Afganistan), nuk ka reaguar fare, i mbronë pasardhësit e këtyre kriminelëve me të cilët është e rrethuar. Xhelali e rrezit cullën në liqenin e Ujmanit pasi e mbron dhe ruan Amir Gërguri, i blinduar si kalorës i Skënderbeut, në 40 gradë celsius dhe të cilit po ky Xhelua donte t'i çante kokën me tulla betoni dhe e kishte shpallur në kërkim përmes fotove WANTED, sikur të ishte Xho Dillinxheri. Nuk reagoi fare as luftëtari i madh për Ujmanin dhe Vatanin që postonte foto nga liqeni, i veshur me mercedeska të kuqe, krejtësisht i gatshëm të sakrifikohej për ....Paradën e Krenarisë, ku do të bëhej edhe komandant. Nuk kishte reagim nga asnjë institucion i sigurisë. As Komandant Mefi, as Dilmali apo partnerja e Radojçiqit. Turpërisht nuk kishte reagim as mendermethënë nga opozita. Reagimi ishte vetëm nga Mehmet Loci, udbashi nga Peja me fakultet të kryer për arkeolog në Zarrë të Kroacisë e i cili nuk punoi fare si arkeolog. Hyri, sigurisht i përpunuar në Kroaci, në sigurimin shtetëror të Jugosllavisë dhe Serbisë. Në vend se të hulumtonte nëntokën për të zbuluar artefakte arkeologjike, ai gërryente organet, shpirtrat

dhe trurin e patriotëve shqiptarë dhe familjet e tyre. Ky, tash paska kërkuar debat te Ermal Panduri, sigurisht jo se mendon të pendohet por se do të përpiqet të shantazhojë të tjerët të mos merren me te. Ky nuk e ka vendin në Debat Plus por e ka vendin në nivelin minus të Dyzit. Dhënia e hapësirës këtyre horrave është ridhunim i viktimave, rehabilitim i dhunës së tyre, humanizim i krimeve të tyre. Ky nuk është për Ermalin, është për Blerimin, Kryeprokurorin Special të Shtetit. I poshtër dhe kriminel. Një copë egërsire i mbështjellë me lëkurë njeriu.

Për lexuesit dhe shikuesit e rrëfimeve të trishta: Në fund të ciklit të intervistave do të keni një numër të konsiderueshëm të emrave të udbashëve që flasim shqip. Të gjithë i njohim, në veçanti rrethi nga janë dhe ku kanë jetuar. Si përfundim, asnjëri nga ata nuk është përballur me ligjin, nuk ka pësuar për krimet që i kanë bërë. Me disa është marrë Zoti, disa kanë fituar azil në shtetet perëndimore, një numër kanë zënë vend në institucionet e vendit, disa janë biznesmenë etj. Sahit Ismajli jeton në Prishtinë, më mirë se vet Hasan Prishtina të cilin institucionet e kanë përzënë nga Prishtina. Vajzën e ka në një pozitë të lartë udhëheqëse. Dhe, kështu me radhë. Prandaj, nuk i kemi punët edhe aq keq, nuk meritojmë më shumë.

## Një grua plagoset nga burri në Fushë-Kosovë

FUSHË-KOSOVË, 6 GUSHT - Një grua është plagosur në Bresje të Fushë-Kosovës në mëngjesin e 6 gushtit. Ajo është dërguar për tretman në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se i dyshuari është burri i viktimës.

Nga Policia e Kosovës thanë se informacionin për plagosje me armë zjarri e morën në orën 07:30 të së martës. "Lidhur me këtë rast policia ka arrestuar një person të dyshuar", tha për "Radion Evropa e Lirë" zëdhënësja e Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

E plagosura është duke u trajtuar në Klinikën e Emergjencës në Prishtinë dhe, sipas drejtorit të kësaj qendre, Naser Syla, ajo është në gjendje stabile. "Gjendja për momentin është stabile. I kemi kryer të gjitha ekzaminimet e



nevojshme. Edhe intervenimet janë kryer. Është ende nën vëzhgim në Qendrën Emergjente dhe më vonë do të vendosim për transferim në klinikën përkatëse", tha Syla për "REL". Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se, sipas informacioneve, i dyshuari ishte

recidivist. "Sipas informacioneve që kemi, personi i dyshuar kishte qenë në mbajtje, por ishte liruar ani pse ishte recidivist dhe sapo është lënë i lirë, ka shtënë me armë zjarri mbi gruan e tij", shkroi ajo në "Facebook". Sipas ministres së Drejtësisë, rasti i ndodhur më 6 gusht është

dëshmia për "neglizhencën e institucioneve të drejtësisë". "Gjithnjë po kërkohet një arsye që dhunesi mos të përballet me pasojat. Këtë rast gjendja shëndetësore e tij. Kjo neglizhencë, këto vendime të gabuara e të nxituara, po i stimulojnë rastet jo vetëm të

dhunës, por edhe të vrasjeve", shkroi ajo.

Plagosja në Fushë-Kosovë ndodhi vetëm katër ditë pasi një grua nga Graçanica vdiq si pasojë e dhunës, që dyshohet se u shkaktua nga bashkëshorti i saj.

Autoritetet i kanë caktuar masën e paraburgimit të dyshuarit për ngjarjen në Graçanicë, përderisa organizatat që merren me të drejtat e grave dhe politikanët kanë kërkuar që sistemi gjyqësor të shqiptojë dënime të ashpra për këto raste.

Në muajin prill, brenda disa ditësh, dy gra u vranë nga bashkëshortët e tyre.

Nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024 në Kosovë janë vrarë 57 gra.

Në të shumtën e rasteve autorët të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

## EUROPOL: Personi i arrestuar në Kosovë për para të falsifikuara, punonjës i MPB-së maqedonase

PRISHTINË, 6 GUSHT - Agjencia Evropiane e Policisë (EUROPOL) tha se personi që u arrestua më 4 gusht në Kosovë për prodhimin e qindra mijërave monedhave false në vlerë prej dy eurove "është identifikuar si punonjës i Ministrisë së Brendshme në Maqedoninë e Veriut". Një ditë më parë autoritetet në Kosovë thanë se ndaj të arrestuarit është caktuar masa e ndalimit prej 48 orëve. "Arrestimi i tij është kulmimi i operacionit disamujor në mes të autoriteteve të Kosovës dhe atyre maqedonase me

mbështetjen e EUROPOL-it dhe Eurojust [Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësinë Penale]", u tha në njoftimin e EUROPOL-it më 6 gusht, raporton REL. Agjencia e BE-së tha se 34-vjeçari i arrestuar në Prishtinë dyshohet se ka falsifikuar qindra mijëra monedha prej dy eurosh në dy vjetët e fundit. Ndërkaq në Maqedoninë e Veriut është thënë se janë kryer kontrole në tri lokacione dhe janë sekuestruar makineri për prodhim të parave të falsifikuara me prerje metalike

dy euro, shabllone parash dhe materiale të tjera për prodhimin e monedhave të falsifikuara, duke përfshirë gjithë lëndën e parë të prodhimit të tyre. Vitin e kaluar Policia e Kosovës kishte iniciuar qindra raste për veprën penale "falsifikim i parasë", ndërsa vlerësohej që në treg qarkullonin qindra mijëra euro false. Paratë false në vlerë të 2 dhe 50 eurove kanë qarkulluar më së shumti. Në disa raste tregtarët e kanë ndaluar kryerjen e pagesave me këto valuta, nga frika e mashtrimit.



## ShBA-ja, BE-ja dhe Gjermania shprehin zhgënjim me vendimin e Kosovës për mbyllje të degëve të Postës së Serbisë në veri

PRISHTINË, 6 GUSHT - Qeveria amerikane ka thënë se është thellësisht e zhgënjyer me ato që i ka cilësuar veprime të njëanshme dhe të pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës kundër degëve të Postës së Serbisë në veri të Kosovës.

Policia e Kosovës ka thënë të hënën se ka mbyllur tri degë të Postës së Serbisë në Mitrovicë të Veriut, tri në Leposaviq, dy në Zveçan dhe një në Zubin Potok. "Veprimet e pakoordinuara të Kosovës përballin shtetasit e Kosovës dhe ushtarët e KFOR-it me rrezik të madh, nxisin përshkallëzim të panevojshëm të tensioneve rajonale dhe minojnë reputacionin e Kosovës si partnere e besueshme ndërkombëtare", është thënë në reagimin e Ambasadës amerikane në Prishtinë.

Në deklaratë i është bërë thirrje Qeverisë së Kosovës t'u japë fund veprimeve të njëanshme dhe t'i



kthehet angazhimit konstruktiv në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për t'i zgjidhur çështjet e normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Bashkimi Evropian, ka thënë, po ashtu, të hënën se veprimet e autoriteteve të Kosovës janë të pakoordinuara dhe se nuk mund të ofrojnë zgjidhje për këtë dhe çështje të tjera që i përkasin

procesit të normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara jo vetëm që janë në kundërshtim me marrëveshjet e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë por, "më keq, rrezikojnë të lënë të bllokuar në postë-aplikimin e Kosovës për

anëtarësim në BE". "BE-ja lulëzon duke mbledhur rreth vetes të gjitha shtetet anëtare dhe komunitetet e tyre dhe ne na duhet qasje e njëjtë në nivel kombëtar", tha Rohde përmes një postimi në "X", teksa shpërnda reagimin e zëdhënësit të bllokut evropian, Peter Stano, lidhur me mbylljen e disa degëve të Postës së Serbisë në veriun e Kosovës. Zyrtarët policorë kanë thënë se kanë nisur aksionin policor pasi kanë marrë informacione nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) se në territorin e Kosovës po operojnë operatorë ekonomikë pa licencë dhe që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe

të shërbimit postar, i cili mbikëqyrë kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit. Mbyllja e objekteve është dënuar prej zyrtarëve të Postës së Serbisë, Listës Serbe dhe institucioneve shtetërore të Serbisë.

Posta e Serbisë në Kosovë kryen pagesa të ndryshme për serbët në Kosovë, prej fondeve që ndan qeveria serbe për ta, përfshirë: pagat, shtesat për fëmijë dhe pensionet. Gjithashtu, përmes Postës së Serbisë, në Kosovë kryhen edhe pagesa të ndryshme për shërbimet që marrin qytetarët nga institucionet paralele, që funksionojnë sipas sistemit të Serbisë, për shembull, pagesa për nxjerrjen e dokumenteve serbe, pagesa për provime, dërgesa të parave e të tjera.

## Murati ngre shqetësimet se disa mërgimtarë po detyrohen t'i paguajnë policat kufitare

PRISHTINË, 6 GUSHT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, u ka bërë thirrje bashkatdhetarëve të mos paguajnë për sigurimin kufitar. Ai ka ritheksuar se policat kufitare janë të mbuluara nga Qeveria e Kosovës.

Ministri Murati ka shprehur shqetësimet e tij, se disa punonjës të Byrosë Kosovare të Sigurimit nuk informojnë saktë që policat kufitare është e subvencionuar dhe kështu po i detyrojnë mërgimtarët të paguajnë. "Të dashur bashkatdhetarë: Mos paguani

për sigurimin kufitar! Policat kufitare njëmuajore për vetura deri në 9 pasagjerë janë të mbuluara nga Qeveria, dhe nuk ka nevojë të paguhet për to, kur hyni në pikat kufitare. Kemi raportime nga disa bashkatdhetarë se punonjës të papërgjegjshëm të Byrosë Kosovare të Sigurimit nuk informojnë saktë që policat kufitare është e subvencionuar, dhe madje edhe i detyrojnë bashkatdhetarët që të paguajnë për së dyti, për policat që tashmë janë të paguara nga

Qeveria. Ftoj të gjithë ata bashkatdhetarë që janë ballafaquar me raste të tilla, ku u është kërkuar të paguajnë për policën kufitare e që do duhej ta merrnin falas, që rastet t'i raportojnë tek policia në numrin 192. Disa raste tashmë janë raportuar dhe kemi pasur edhe procedimin penal për punonjësit e BKS-së. Njëkohësisht ftoj edhe Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë që t'i trajtojnë me prioritet këto raste të keqpërdorimeve", ka shkruar Murati në "Facebook".



## Sveçla mbron aksionin për mbylljen e degëve të Postës së Serbisë

Prishtinë, 6 gusht - Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, e ka mbrojtur aksionin e autoriteteve të Kosovës të ndërmarrë më 5 gusht, kur u mbyllën nëntë degë të Postës së Serbisë në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Gjatë një vizite në Mitrovicë të Veriut, Sveçla u pyet nga gazetarët për aksionin, i cili u kritikua nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Çfarë janë duke bërë institucionet e Kosovës është shumë normale. Ato nuk kanë pasur licencë", tha Sveçla.

Një ditë më parë nga Policia e Kosovës thanë se aksioni u zhvillua pas informatës së pranuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) se në territorin e Kosovës po operojnë operatorë ekonomikë pa licencë dhe që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Autoritetet mbyllën tri objekte në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq, dy në Zvečan dhe një në Zubin Potok.

Bashkimi Evropian e kritikoi aksionin, duke thënë se ishte një veprim i njëanshëm dhe i pakoordinuar i autoriteteve të Kosovës.



Bloku argumentoi se një veprim i tillë shkel dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga BE-ja. Edhe Shtetet e Bashkuara thanë se janë "thellësisht të zhgënjyera" për mbylljen e degëve të Postës së Serbisë.

Ambasada Amerikane në Prishtinë tha se veprimet "e pakoordinuara të Kosovës përbaljnë shtetasit e Kosovës dhe

ushtarët e KFOR-it me rrezik të madh, nxisin përshkallëzim të panevojshëm të tensioneve rajonale dhe minojnë reputacionin e Kosovës si partnere e besueshme ndërkombëtare".

Mbyllja e objekteve u dënua edhe nga zyrtarët e Postës së Serbisë, Lista Serbe dhe institucionet shtetërore të Serbisë.

Sveçla gjatë qëndrimit në

Mitrovicë të Veriut u pyet nëse duhet të hapet për qarkullim të veturave ura mbi lumin Ibër që ndan Mitrovicën e Jugut, të banuar me shumicë shqiptare, me atë të Mitrovicë të Veriut, të banuar me shumicë serbe. "Ura do të hapet. Nuk ka asnjë arsye që të mos hapet. Tash kur do të hapet është çështje e vlerësimit të ekspertëve", tha ai.

Qeveria e Kosovës së fundi ka përsëritur qëndrimin e saj që ura

duhet të hapet për qarkullim. Në fillim të gushtit, kryeministri Albin Kurti paraqiti para përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të QUINT-it dhe BE-së planin e qeverisë për hapjen e urës mbi lumin Ibër. "Plani parashihet testimet për stabilitetin infrastrukturor të urës, vlerësimin e rrezikut dhe rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, rivitalizimin vizual të urës me qasje në urë për të gjithë, diskutimet me qytetarë dhe grupe të interesit si dhe fushatën e informimit gjithëpërfshirës mbi përfitimet dhe qëllimet e hapjes së urës", tha qeveria më 2 gusht.

Por, hapja e urës po kundërshtohet nga bashkësia ndërkombëtare. BE-ja, ndërkaq, po kërkon që çështja e urës të jetë temë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi palët janë pajtuar që ura të hapet për qarkullim, por kjo nuk është realizuar kurrë në praktikë. Është hapur vetëm njëra anë e saj për këmbësorë.

Diskutimet për urën janë aktualizuar muajt e fundit pas thirrjeve në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut që ura të hapet tërësisht për qarkullim. Këtë komunë në veri të Kosovës e udhëheq Erden Atiq nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje.

## Ministri i Bujqësisë vizitoi "Agroproduct - Sh. P. K", kompani lidere për kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore aromatike



PRISHTINË, 6 GUSHT - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka vizituar kompaninë "Agroproduct - Sh. P. K.", e cila ka 40 pika grumbulluese në tërë territorin e Kosovës me rreth 3 000 mbledhës të kontraktuar në gjithë vendin.

Eksportet e tyre mbulojnë shtetet evropiane, Britaninë e Madhe, ShBA-në dhe Kanadanë. "Gjatë vizitës tek 'Agroproduct - Sh. P. K', kompani lidere në Kosovë për kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e

bimëve mjekësore aromatike dhe frutave malore, pashë nga afër sukseset dhe kapacitetet me të cilat ata operojnë. Me 25 lloje bimësh të kultivuara dhe 75 lloje bimësh të grumbulluara, të gjitha me certifikim organik, 'Agroproduct - Sh. P. k.' posedon 40 pika grumbulluese në tërë territorin e Kosovës me rreth 3 000 mbledhës të kontraktuar në gjithë vendin. Eksportet e tyre mbulojnë shtetet evropiane, Britaninë e Madhe, ShBA-në dhe

Kanadanë. Produktet e tyre kanë ranguar Kosovën në vendin e 7-të në botë si një nga eksportueset më të mëdha të produkteve organike, duke lënë pas të gjitha vendet e rajonit. Tani, me themelimin e 'Bliff Organik Sh. P. K.', ofrojnë përpunimin final të çajrave dhe bimëve mjekësore aromatike sipas standardeve organike, duke zgjeruar kështu gamën e produkteve të tyre cilësore", ka shkruar Peci në "Facebook".

## Komuna e Rahovecit mban dëgjimin buxhetor me përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve dhe të rinisë

RAHOVEC, 6 GUSHT - Komuna e Rahovecit ka njoftuar se cikli i dëgjimeve buxhetore ka vazhduar me përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve, rinisë, përfaqësues të shkollave dhe grupet e interesit, në sallën e Kuvendit Komunal, për t'i mbledhur kërkesat dhe nevojat mbi buxhetin e vitit 2025. Për të siguruar që buxheti t'i reflektojë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve, është thelbësore pjesëmarrja aktive e tyre në këtë cikël.

Dëgjimin e moderoi shefi i kabinetit të kryetarit, Ali Morina. Kryetari i komunës, Smajl Latifi, paraqiti informacionet kyçe lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit të komunës, kurse drejtori i Financave, Afrim Limani, shpalsi në mënyrë të hollësishme buxhetin e komunës së Rahovecit për vitin 2025.

Buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2025 do të jetë në vlerë

20.982.000 euro.

Kërkesat që u parashtruan ishin: Një lagje të mbillet me hardhi të rrushit dhe të emërtohet "Lagja e hardhisë"; Ndërtimi i një parku Te Rrasat; Rregullimi i murit te varrezat e serbëve.

Në vazhden e debatit pati edhe biseda interaktive të përgjithshme rreth kërkesave të ndryshme.

Komuna e Rahovecit ka njoftuar se grupi punues do t'i shqyrtojë pyetjet dhe kërkesat.





# Sali Bashota

(Avni Spahi, diplomat, publicist, përkthyes)

Një ditë pranvere e javës së fundit të prillit të vitit 2022, në një takim miqësor me Avni Spahiun në restorantin "Symphony" në Prishtinë, biseduam për shumë tema, ngjarje, situata, përjetime, kujtime, por edhe për shumë çështje, fenomene e dukuri të pranishme në realitetin tonë e më gjerë. Po atë ditë, sikur m'u ngulit në mendje që të bëja një intervistë të gjatë me të dhe që të botohet si libër i veçantë nga Botimet REA.

Me Avni Spahiun është shumë lehtë të bisedosh dhe natyrisht edhe të pajtohesh me idetë dhe mendimet e tij, kur ai flet për një varg temash e ngjarjesh të ndryshme. Prandaj me mirëkuptim e dashamirësi të plotë, u pajtuam që bashkëbisedimi ynë të përqendrohet në disa drejtime, duke filluar nga fëmijëria, rinia, studimet, gazetaria, përkthimi, kultura, letërsia, leximi, diplomacia, paqja, lufta, familja, dashuria, ëndrrat, liria, pastaj edhe për personalitetet publike me ndikimin në rendin botëror, apo për personalitete të historisë dhe të kulturës shqiptare. Kënaqësia e bashkëbisedimit sikur e shtresonte në vete artin e bukur të fjalës dhe të mendimit, meqë Avni është i saktë dhe i qartë në çdo përgjigje të tij.

Në fakt, qetësia, modestia, thjeshtësia, mendjemprehtësia e Avni Spahiut e shpërfaqnin guximin e nismës time për të shpallur Ditarin e Jetës së tij në kohë dhe rrethana të ndryshme. Por, ishte përpjekja ime e vazhdueshme për ta realizuar idenë e komunikimit në rrugëtimin e tij nëpër vitet e lumtura, por edhe nëpër vitet e vështira, të cilat i kemi përjetuar si popull. Por, përvoja e tij e jashtëzakonshme në shumë segmente të jetës më vuri në "siklet", për ta mbrojtur qëllimin e këtij bashkëbisedimi, se cilat pyetje do të ishin më të qëlluara që do ta shpalosnin më së miri realitetin tonë, kuptohet përbrenda rrethanave të caktuara politike, diplomatike e kulturore apo cilat pyetje do ta "ngacmonin" më shumë Avniun, për të arritur deri te njëra ndër porositi kryesore të bashkëbisedimit, duke i shpallur një nga një ato faqe miqësie, siç thoshte Avni, për t'i evidentuar dhe

karakterizuar, sidomos marrëdhëniet me shumë vende mike të Kosovës, në mënyrë të veçantë marrëdhëniet shqiptaro-angloamerikane.


Avni Spahiun në të gjitha pyetjet e mia doli si rrëfimtari i sigurt, i arsyeshëm dhe bindës, duke i ruajtur karakteristikat e përgjigjeve me invencion, përkushtim të veçantë dhe me plot ngrohësi.

Duke filluar nga fëmijëria, rinia, studimet, në njërin anë dhe për të vazhduar nëpër etapat e tjera të jetës dhe të krijimtarisë së tij që ndërlidhen me publicistikën, diplomacinë dhe përkthimin letrar, në anën tjetër. Kuptimi, domethënia dhe esenca e mendimeve të Avni Spahiut e kanë thellësinë dhe lartësinë e vet. Para së gjithash, profesionalizmi e tij e zgjon filozofinë e botëkuptimeve dhe botëpërjetimeve për shumë ngjarje të kaluara dhe aktuale që i ka përjetuar edhe vetë, duke qenë jo rrallë edhe protagonist i zhvillimeve politike dhe në mbrojtje të të drejtave njerëzore dhe kombëtare.

Prandaj bashkëbisedimi me të, nuk është thjesht vetëm një vargëzim i ligjërit publicistik për të shpallur sa më shumë kujtime apo për ta qartësuar shtegun e pasionit për disa tema të ndryshme që janë kumbuese me efektin e tyre, por edhe të shpjeguara me cilësinë dhe emocionalitetin e figurshëm. Pa dyshim, se janë trajtuar bindshëm, sidomos me stilin e shkrimit, në radhë të parë, për të paraqitur një kohë të përjetuar me përvojën e tij intelektuale, publicistike e diplomatike.

Bashkëbisedimi me Avni Spahiun shkon përtej kohës dhe hapësirës ku skicohet jeta e intelektualit shqiptar me finesat e saj për të dëshmuar shtegtimin e një djaloshi që qysh në rini frymëzohet nga ëndrrat e bukura të jetës amerikane. Bashkëbisedimi me Avni Spahiun dëshmon për zërin autentik të intelektualit dhe për përvojën e tij personale që ka shtresime të gjera intelektuale në periudha të ndryshme, madje duke qenë edhe njëri ndër njohësit më të mirë të proceseve politike që ndërlidhen me shqiptarët, Kosovën, Ballkanin dhe më gjerë.

Si publicist e ka artikulluar



realitetin shqiptar për të dëshmuar lirinë, të drejtën dhe të vërtetën për shqiptarët e Kosovës, duke qenë gjithmonë i qartë dhe argumentues me shkrimet e tij dhe me përfaqësimin diplomatik në disa shtete të botës, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Edhe kur flet për takimet me presidentë e diplomatë amerikanë, edhe kur flet për takimet dhe bashkëpunimin e gjatë me Ibrahim Rugovën, pastaj me Adem Demaçin etj., edhe kur flet me takimet me Ismail Kadarenë, apo për miqësinë me Azem Shkrelin, Ali Podrimjen, Basri Çapriqin, Qani Mehmedin dhe me miq të shumtë që i ka takuar në vende të ndryshme të botës, si dhe me miqtë e tij në Kosovë, Avni Spahiun, është gjithmonë i njëjti, i afërt dhe miqësor. Po kështu, bashkëbisedimi me Avni Spahiun për çështje dhe fenomene të letërsisë dhe të kulturës në përgjithësi vetvetiu e krijon një kod të komunikimit i cili i ka shenjat

e veta të veçanta, duke i karakterizuar aktivitetet e tij të shumta krijuese, qoftë si përkthyes, publicist, autor veprash të rëndësishme, por edhe si diplomat dhe veprimtar i çështjes kombëtare. Cilat janë sfidat, vështirësitë dhe kënaqësitë që paraqet prezentimi i një kulture tek një tjetër; cilat janë proceset që karakterizojnë mediet në Kosovën e pasluftës dhe si ishte gazetaria në kontekstin e dekadës së nëntëdhjetë; si po e (keq) përdorim gjuhën e shkruar dhe atë publike, cili është roli i intelektualit sot në Kosovë, e aspekte të tjera janë disa nga pyetjet dhe çështjet e shtruar. Në këtë intervistë, Avni Spahiun, jep informacione me interes për autorë të letërsisë shqipe, por edhe për autorë të letërsisë botërore, duke përfshirë edhe nobelistët, si dhe për shumë dukuri dhe probleme të gazetarisë në Kosovë, në periudha të ndryshme. Bashkëbisedimi me Avni Spahiun e ka magjinë e

vet të frymëzimit edhe për veprimtarinë e tij në shumë drejtime. Përmbajtja dhe mesazhi i përgjigjeve të tij paraqesin sintezën e informacioneve të sistemuara me origjinalitet dhe me një invencion të rrallë kreativ, që do të ishte model për publicistët shqiptarë.

Libri "Arti i bashkëbisedimit", i sajuar përmes pyetjeve të mia dhe përgjigjeve të tij është njëri ndër artikulet më pasionante të Avni Spahiut që ka të bëjë me kulturën, letërsinë, diplomacinë, përkthimin, publicistikën etj. Për më tepër, ky libër me përmbajtjen dhe informacionin që ofron, gjithsesi, i ka shenjat e veta të përveçme, pikërisht me stilin, gjuhën, mjeshtërinë e rrëfimit, por edhe me përbërës të tjerë të shumtë që dëshmojnë për vlerën e mendimeve autentike dhe për pikëpamjet shumëdimensionale të Avni Spahiut. Një cilësi dhe një pasurim i mendimit shqiptar sot.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit


## Federata Evropiane e Xhudos: Suksesi i xhudisteve, burim krenarie kombëtare për Kosovën

PRISHTINË, 6 GUSHT - Federata Evropiane e Xhudos ia ka dedikuar një artikull xhudisteve kosovare dhe impaktin e tyre në Kosovë. "Xhudo në Kosovë ka fituar njohje të konsiderueshme,

posaçërisht shkak u arritjeve të jashtëzakonshme të sportistëve të saj në skenën ndërkombëtare", shkruan Federata Evropiane e Xhudos. "Suksesi i këtij vendi në xhudo

është burim krenarie kombëtare, dhe ka ndihmuar të ngrehë profilin e sportit brenda Kosovës". "Legjenda e tyre e gjallë, kampionia olimpikë, Majlinda Kelmendi, ishte në

ngjarje në Paris, por për herë të parë në Lojërat Verore, ajo që ulur anash por kishte mbetur në aksion". "Trajnimi përkundër garimit ishte një përvojë ndryshe".



## Pritje shtetërore për ekipin olimpiq që përfaqësoi Kosovën në Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, mori pjesë dhe mbajti fjalimin kryesor në pritjen shtetërore të organizuar për nder të kampionëve dhe ekipit tonë olimpiq të cilët kanë përfaqësuar Kosovën në Lojërat Olimpikë në "Paris 2024". "Të nderuar të pranishëm që keni ardhur këtu, me gëzim dhe krenari të mirëprisni ekipin tonë olimpiq. Si Kryeministër i Republikës së Kosovës, në emër të gjithë qytetarëve tanë, kam

nderin t'ju përgëzoj për sukseset tuaja dhe t'ju uroj mirëseardhje për kthimin me plotë krenari në shtetëpinë tuaj. Për pjesën e ekipit e cila ndodhet ende në Paris, ju presim krahëhapur në Kosovën tuaj të dashur", ka thënë kryeministri Kurti. Ai u shpreh se dikur dukej imagjinare ta mendosh se Kosova triumfon para shteteve – që janë fuqi botërore, por tani ky fakt është bërë realitet bindës, të cilin të gjithë ne po e gëzojmë. "Ky vend të cilin ju e bëtë krenarë, do të mbajë gjithmonë të hapur rrugën tuaj për të shkuar sa më

lehtë e sa më shpejt drejt sukseseve të tjera, drejt sukseseve të reja", ka deklaruar ai. Para të pranishmëve një fjalë rasti mbajti edhe trajneri Driton Kuka, i cili tha se është nder dhe kënaqësi që po ju shoh këtu pasi është hera e tretë me radhë nga tri lojëra olimpikë po kthehemi me medalje. Pritja shtetërore u organizua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe u mbajt në sheshin "Xhorxh Bush", në Prishtinë, ku përveç përfaqësuesve shtetërorë, kishin dalë për të pritur kampionët olimpikë edhe qytetarë të shumtë.



## I jepet lamtumira e fundit Izet Gjinovcit

PRISHTINË, 6 GUSHT - I është dhënë lamtumira e fundit sekretarit të Përgjithshëm të Federatës së Hendbollit, Izet Gjinovci. Një numër i madh i qytetarëve dhe sportistëve morën pjesë në varrimin e njeriut që gjithë jetën ia kushtoi sportit, konkretisht hendbollit. Të martën paradite në Sallën e Administratës Qendrore të Universitetit të Prishtinës është mbajtur mbledhja komemorative për Izet Gjinovcin. Gjinovci, që kishte një jetë në hendboll, ndërroi jetë të hënën paradite. Prej vitit 2002 e deri në frymën e fundit e ka mbajtur pozitën e sekretarit të përgjithshëm të FHK-së. I ndjeri Gjinovci ishte për mbi katër dekada në hendboll, ndërsa ka kontribuar në pozita të ndryshme. Për kontributin e çmueshëm të sekretarit të përgjithshëm Gjinovci, foli presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini. "Shumë e vështirë të



flas për Izetin, të cilin e kam njohur për më shumë se dy dekada. Ai ka hyrë në histori të hendbollit dhe sportit kosovar me përkushtimin, angazhimin, ndihmën dhe përkrahjen e klubeve dhe të ekipeve kombëtare të hendbollit. Ishte e këndshme të punosh me Izetin, edhe atëherë kur nuk kemi pasur mendime të harmonizuara. Por një situatë e

tillë kalohej për pak sekonda. Së bashku ia kemi dalë", ka thënë presidenti Saraçini, që ka ndarë me të pranishmit e shumë momente të veçanta nga e kaluara e përbashkët me të ndjerin. Ai e ka falënderuar bashkëshorten e të ndjerit, Valbonën, që i qëndroi pranë "mikut të të gjithëve" deri në fund. "Izeti ishte i respektuar edhe në EHF, ishte kosovari i

parë që nominalisht u bë anëtar i EHF-së. Me presidentin e EHF-së dhe atë të IHF-së ka folur sikur të njihen për shumë e shumë vite. Ai është prej njerëzve që ka dhënë shumë më tepër për hendbollin se ndoshta për familjen e tij. Është e vështirë të ndahemi me të në këtë mënyrë. Por, çdo pikë loti që na shkon është edhe gëzim që kemi pasur pranë një njeri si ai", ka shtuar presidenti Saraçini. Në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, për personalitetin e Izet Gjinovcit foli Daulina Osmani, zëvendësimistër e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ajo e ka cilësuar Gjinovcin doajen të hendbollit dhe sportit kosovar. "Ishte frymëzim, shtyllë kyçe e zhvillimit të sportit të Kosovës. Vepra e tij është motiv e frymëzim për gjeneratat e reja. Izeti ka qenë prej të paktëve nga komuniteti sportiv prej të cilit kam dëgjuar rrëfime për sportin e Kosovës", ka thënë

zëvendësimistërja Osmani. Në emër të familjes ka folur bashkëshortja e të ndjerit, Valbona. "20 vjet më parë mora rrugë për në Prishtinë. Për 20 vjet më dha dashuri e kujdes. Por nuk isha dashuria më e madhe e tij. Dashuria më e madhe e tij ishte hendbolli. Ishim si në dy anë të peshores, ndërsa hendbolli fitoi. Ishte aq i fortë sa që nuk mendonte sëmundjen, por vetëm rezultatet e hendbollit", ka thënë ajo, duke falënderuar Dr. Ilir Kurtishin për kujdesin e madh për plot tri vjet ndaj të ndjerit. Valbona Gjinovci ka falënderuar edhe gjithë bashkëpunëtorët e të ndjerit, duke veçuar Muhamet Arifin, asistentin e tij. "Ai ishte si djali i Izetit e tani është si djali im". Në fund për personalitetin e Izet Gjinovcit foli edhe miku i tij, Sokol Axhemi. Varrimi i të ndjerit bëhet sot nga ora 17:00 në varrezat e fshatit Makërmal, në komunën e Skenderajt.

## Hyseni përforcon Feronikelin '74

DRENAS, 6 GUSHT - Feronikeli '74 ka njoftuar se Hasan Hyseni është zyrtarisht pjesë e tyre. Anësori 27-vjeçar ishte pjesë e Prishtinës së fundmi, ndërsa nga sezoni 2024/25 do të mbrojë ngjyrat e

klubit nga Drenas. "Kemi kënaqësinë të ju informojmë që futbollisti, Hasan Hyseni, është transferimi i radhës tek klubi ynë, FC Feronikeli 74. Hyseni, i cili sezonin e kaluar ishte pjesë e FC

Prishtina, ka përvojë të jashtëzakonshme në këmbët e tij, e njëjshëm mirë Superligën e Kosovës dhe padyshim që do të jetë vlerë e shtuar e klubit. Anësori 27 vjeçar i është bashkuar

skuadrës deri në fund të sezonit, por në kontratën e tij me klubin ka edhe mundësinë e vazhdimit. Ne si klub shpresojmë që rugët tona të jenë të gjata dhe të suksesshme", thuhet në njoftimin e Feronikelit.



## NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se akcionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Madame Boutique Sh.p.k me numër unik identifikues: 812043818 me seli në Prishtinë, Adresa: Rrustem Statovci, Blloku i ri, ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Granit Baliu me ID: 1231043574 me vendbanim në: Rr. Isa Kastrati nr. 78 Albing Residenc Komuna: Prishtine me tel: 049/834-824

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik

që kanë interesa të përcaktuar dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "PICKLED" SH.P.K. me seli në Fushë-Kosovë, ka marrë vendim të shuarje biznesin me nrb. 811962473 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "PICKLED" D.O.O. Fushë-Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811962473 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "PICKLED" L.L.C. with headquarters Fushë-Kosovë, has come to the decision to quit its business: 811962473 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Veton Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811974303.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

